



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më, 30. 08. 2019

**VENDIM**

**Nr. 41, datë 30. 08.2019**

**MBI**

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE TË REJA DHE TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË:  
"ASISTENCË NË GERIARTRI" DHE "SHËRBIME KUJDESI PËR FËMIJË"**

Mbështetur në nenin 49, pika 1, shkronja dh, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit nr.31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimeve nr.24 dhe nr. 25, datë 01. 07. 2019 si dhe shkresat Nr. 917/2, datë 11. 07. 2019 dhe Nr. 1006 prot, datë 31. 07. 2019 të Administratores, shkresës nr. 917/1 prot., datë 11.07.2019 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30. 08. 2019

**VENDOSI**

1. Të miratojë hapjen e programeve të reja të studimit dy vjecar, për vitin akademik 2019-2020 në Fakultetin e Shëndetit, si më poshtë:

"Asistencë në Geriartri"

"Shërbime Kujdesi për Fëmijë"

2. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për programet e reja profesionale dy vjecare, si më poshtë:

- 20. 000 lekë tarifa vjetore e shkollimit në program të ciklit të parë të studimit

sipas propozimit të përcjellë me shkresën Nr. 917/1, datë 11. 07. 2019 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, bashkëlidhur vendimit.

- 80. 000 lekë tarifa vjetore e shkollimit në program të dytë studimi në ciklit të parë.

sipas propozimit të përcjellë me shkresën Nr. 917/1, datë 11. 07. 2019 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, bashkëlidhur vendimit.

3. Një kopje e këtij vendimi së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

4. Bashkëlidhur këtij vendimi vendoset edhe kopje e shkresave Nr. 917/2, datë 11. 07. 2019 dhe Nr. 1006 prot, datë 31. 07. 2019 të Administratores së Universitetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar